



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KRYETAR



Nr. 18346 prot datë 11.12.2017

Nr. 259/11 prot datë 12.12.2017

KONTRATË QIRAJE

E lidhur sot me dt. 11.12.2017 ndërmjet palëve:

1. **Qiradhënësi** : Bashkia Shkodër, institucion publik me nr NIPT K36813001H, me seli ne Rr. 13 Dhjetori Shkodër, përfaqësuar nga Kryetare Znj. Voltana Ademi, lindur ne Shkoder dhe banuese në Shkodër, madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, që më poshtë do të quhet "Qiradhënësi".

Dhe

2. **Qiramarrësi** : Shoqëria "Banka e Tiranës" Sh.A. – e organizuar dhe që ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS J61924008V, me seli ne Rrugën "Ibrahim Rugova" Tirane, përfaqësuar nga përfaqësueset e posaçme: Drejtore e Divizionit te Kredive me Probleme dhe Administrimit të Pronave të Bankës, Znj. Elona SEJKO (GJIPALI), e bija e Koços, e datelindjes 31.08.1976, lindur ne Tirane, banuese ne adresen Bulevardi "Zogu I", Pall 9/13/15, Seksioni 2, Ap. 34, Tirane, identifikuar me leternjoftimin Nr.030614391 (Nr. Personal H65831109E), madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar dhe Drejtore e Divizionit Operacional (COO) dhe Znj. Eralda TAJAJ, e bija e Xhevdetit, e datelindjes 01.05.1978, lindur ne Tirane, banuese ne adresen Rruga "Isa Boletini", Tirane, identifikuar me leternjoftimin Nr.027993672 (Nr. Personal H85501240Q), madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar, ne baze te Prokures se Posaçme me Nr.236Rep, e Nr.130/2Kol, datë 30.01.2017 te noteres -----, (më tej referuar si "QIRAMARRESI").

Baza ligjore

- Kodi Civil
- Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"
- Vkm Nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qera, enfitheozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar
- Vkb nr. 59, datë 30.09.2017 "Për dhënie pëlqimi për dhënie me qira një ambienti me sipërfaqe 7.5 m<sup>2</sup>, pronë e Bashkisë Shkodër .

Neni 1

Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate, është dhënia me qira e pasurisë së paluajtshme me sipërfaqe 7.5 m<sup>2</sup> pjesë e pasurisë së paluajtshme me nr. 4/250, në Zonën Kadastrale 8594, volum 17, faqe 166, ndodhur në qytetin Shkodër, rruga 28 Nëntori, pasuri në pronësi të Bashkisë Shkodër, me qëllim që Banka ta përdorë për vendosjen e një bankomati (me poshte "ATM") gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate sipas kushteve të mëposhtme dhe planimetrisë bashkëngjitur.



## Neni 2

### Pagesa

- 2.1 Qiramarrësi detyrohet t'i paguajë qiradhënësit detyrimin mujor në vlerën prej 1 125 (një mijë e një qind e njëzet e pesë) lekë /muaj .
- 2.2 Pagesa e qirasë do të jetë mujore dhe do të bëhet brenda datës 10(dhjetë) të fillimit të muajit për llogari të Institucionit (Bashkia Shkodër), në llogarinë e të ardhurave, Dega e Thesarit Shkodër . Ose
- 2.3 Qiramarrësi detyrohet t'i paguajë qiradhënësit detyrimin vjetor në vlerën prej në vlerën 13 500 (trembëdhjetë mijë e pesëqind ) lekë/vit .
- 2.4 Pagesa e qirasë do të jetë vjetore dhe do të bëhet me nënshkrimin e kontratës për llogari të Institucionit (Bashkia Shkodër), në llogarinë e të ardhurave, Dega e Thesarit Shkodër .

## Neni 3

### Afati i Kontratës - Përfundimi – Zgjidhja

- 3.1 Kohëzgjatja e kësaj kontrate është 1(një) vit kalendarik, duke filluar nga data e nënshkrimit saj, me të drejtë rinovimi cdo vit .
- 3.2 Rinovimi ose zgjatja e kësaj kontrate do të bëhet në bazë të marreveshjes me shkrim te paleve, duke perjashtuar keshtu çdo marreveshje verbale ose informale.
- 3.3 Kjo kontrate do te perfundoje ne daten e mbarimit te afatit te kohezgjatjes se kontratës, percaktuar ne paragrafin e mesiperm, pa qenë e nevojshme shpallja e mbarimit të saj.
- 3.4 Secila palë kontraktuese mund ta përfundojë në mënyrë të njëanshme kete kontrate në rastet kur:
  - a) palët bien dakort që mund të zgjidhin kontratën nepërmjet një njoftimi paraprak me shkrim 1 (nje) mujor drejtuar paleve, duke mos shkaktuar dëm kështu asnjërës prej palëve dhe pa u kërkuar kryerja e ndonjë procedure tjetër.
  - b) Kjo kontratë mund të zgjidhet nga secila prej palëve, me efekt të menjëhershëm, në rast të shkeljes së ndonjë prej kushteve të saj ose për shkak të evidentimit të rasteve të forcës madhore.
- 3.5 Ne rast te zgjidhjes se kontrates para afatit si dhe ne rast ku pagesa eshte bere paraprakisht per te gjithë kohezgjatjen e kontrates nga Qiramarrësi sipas pikes 2.3 me siper, atehere Qiradhenesi detyrohet te ktheje shumen perkatese ne varesi te momentit te zgjidhjes se kontrates.

## Neni 4

### Vendi i instalimit të ATM

- 4.1 ATM do te instalohet dhe do te perdoret ne pjesën perkatese sipas planimetrise bashkengjitur kesaj kontrate, te pasurisë së paluajtshme me nr. 4/250, në Zonën Kadastrale 8594, volum 17, faqe 166, ndodhur në qytetin Shkodër, rruga 28 Nëntori, pasuri ne pronesi te Bashkise Shkoder.
- 4.2 ATM do te instalohet ne brendesi te hapësires se Bashkise Shkoder dhe do te zere nje siperfaqe prej 7.5 m2 (shtatë pike pese metra katrore), sipas planimetrise bashkëngjitur kontratës.
- 4.3 Palët kanë zgjedhur dhe rënë dakort me vullnet të plotë , për vendin e instalimit të ATM.

## Neni 5

### Të dhënat e ATM

- 5.1 ATM do te jete ne sherbim te klienteve 24ore/dite, 365 dite/vit, pa patur ndonje kufizim si p.sh orari zyrtar i punes, festa zyrtare, dite javore pushimi etj.
- 5.2 ATM do te mbaje shenjat dhe ngjyrat dalluese tregtare të Bankës.
- 5.3 Banka rezervon te drejten te instaloje nje shenje ndriçuese dalluese me logon e saj ne piken e instalimit te ATM.
- 5.4 Banka do te perballoje te gjitha shpenzimet e prodhimit dhe instalimit te kesaj shenje.
- 5.5 Vendi ekzakt i instalimit si dhe permasat e shenjes do te vendosen me marreveshje midis paleve kontraktuese, sipas legjislacionit në fuqi.



## Neni 6

### Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit ( Bankës)

- 6.1 Qiramarrësi duhet të përdorë pasurinë objekt i kësaj kontratë vetëm për qëllimin dhe destinacionin e parashikuar në nenin 1.
- 6.2 Qiramarrësi duhet të paguaj detyrimin mujor /vjetor të qirasë mbrenda afatit të përcaktuar në këtë kontratë.
- 6.3 Qiramarrësi do të paguaje të gjitha shpenzimet për lidhjen me linjen telefonike dhe për funksionimin e ATM (ALBTELECOM ose satelitore), si dhe të gjitha shpenzimet për instalimin, vendosjen, zhvendosjen, mirembajtjen dhe zevendesimin e ATM.
- 6.4 Qiramarrësi (Banka) do të jete gjithashtu përgjegjës për të siguruar funksionimin normal dhe pa probleme të ATM, dhe do të jete e detyruar të riparojë difektet brenda një periudhe të arsyeshme kohe.
- 6.5 Për të garantuar sigurinë e ATM, Banka do ta instalojë duke e mberthyer në toke në katër pika, dhe gjithashtu do të marrë të gjitha masat e nevojshme për funksionimin e sigurt të saj.
- 6.6 Vendi fillestar i instalimit të ATM si dhe zhvendosja në një vend tjetër do të jete subjekt i miratimit me shkrim nga të dy palët.
- 6.7 Qiramarrësi (Banka) merr gjithashtu përgjegjësinë të furnizojë me cash ATM.
- 6.8 Qiramarrësi (Banka) nuk do të jete përgjegjës në rastet e mosfunksionimit të ATM për shkak që nuk vijnë nga pakujdesia e rende të Bankes, përfshirë këtu keqfunksionimin e sistemit të Bankes, mosfunksionimin e rrjeteve të telekomunikimit të transferimit të të dhënave, ose rasteve të forës madhore perkufizuar si raste ose ngjarje që janë tej kontrollit ose ndikimit të Bankes dhe nuk mund të parashikohen edhe nëse Banka tregon kujdes të veçantë, si dhe të gjitha ngjarjet për të cilat Banka nuk është përgjegjëse.

## Neni 7


### Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit (Bashkia Shkodër)

- 7.1 Qiradhënësi (Bashkia Shkodër ) merr përsipër të krijojë qiramarrësit mundësinë që të përdorë objektin qetësisht.
- 7.2 Qiradhënësi merr përsipër të sigurojë mundësinë për lidhjen me rrjetin elektrik të ATM dhe shenjës së ndriçuar.
- 7.3 Qiradhënësi është i detyruar t'i lehtësojë hyrjen punonjësve të Bankes dhe stafit teknik për të furnizuar, mirembajtur dhe riparuar ndonjë difekt.
- 7.4 Qiradhënësi siguron Bankën Tirana Bank se kjo kontratë për dhënie me qira nuk krijon asnjë konflikt me ndonjë interes të palëve të treta.
- 7.5 Qiradhënësi nuk përgjigjet për pretendime të tjera që nuk kanë të bëjnë me objektin dhe qëllimin e kontratës.

## Neni 8

### Ekskluziviteti – Penaliteti

- 8.1 Gjate kohezgjatjes së kësaj kontrate, pronari merr përsipër detyrimin të mos lejojë instalimin e ndonjë ATM ose ofrimin e shërbimeve bankare nga ndonjë institucion tjetër krediti përveç "BANKA e TIRANES" Sh.a, në vendin e instalimit.
- 8.2 Shkelja e kushtit të ekskluzivitetit të BANKA e TIRANES për instalimin dhe përdorimin e ATM, do të shkaktojë penalizimin e Pronarit dhe detyrimin e tij për të paguar në favor të BANKA e TIRANES një penalitet në shumën € 0, që palët kontraktuese e pranojnë si ligjore dhe të arsyeshme.



3) Në rast aplikimi të penaltetit të sipër përmendur, kjo kontratë do të përbejë një instrument të ekzekutueshëm, dhe përdoruesit tani e tutje deklarojnë se heqin dore nga objeksionet e mundshme.

#### Neni 9

##### **Kufizimi i përgjegjësise se paleve**

9.1 Secila prej paleve do të shperbleje demet materiale qe pala tjetër mund të pesoje pas vleresimit të llojit të demit dhe mases së tij. Detyrimi i sipër përmendur për shperblimin e demeve do të percaktohet në procesverbalet perkatëse të mbajtura mes perfaqësuesve të paleve dhe vlera e tij do të jete ajo e faturave perkatëse për riparimin e demit.

#### Neni 10

##### **Dispozita të fundit**

10.1 Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në këtë kontratë, palët do të referohen dispozitave të Kodit Civil që rregullojnë kontratën e qirasë.

10.2 Kjo kontratë do të udhëhiqet dhe rregullohet nga legjislacioni shqiptar dhe çdo ndryshim i kushteve të kësaj kontrate midis palëve do të bëhet me shkrim.

10.3 Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve gjatë zbatimit të kësaj kontratë do të zgjidhen me mirëkuptim mes palëve.

10.4 Në rast se kjo është e pamundur, palët kanë të drejtë t' i drejtohen Gjykatës.


Palët kontraktuese ranë dakort sa më sipër dhe kjo kontratë u pergatit dhe u nënshkrua në tre (3) kopje origjinale.

#### **Palët Kontraktuese**

**QIRADHËNËSI**



**BASHKIA SHKODER**

**KRYETARE**



**QIRAMARRËSI**

**TIRANA BANK**

  
  
**Znj. Elona GJIPALI**

**Znj. Eralda TAHAJ**